

VENDIM
Nr. 27, datë 1.6.2022

**PËR MIRATIMIN E ÇMIMIT TAVAN TË TREGTIMIT ME SHUMICË/PAKICË TË
NËNPRODUKTEVE TË NAFTËS DHE TË GAZIT**

Bordi i Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe të Gazit, në mbështetje të nenit 21/3, të aktit normativ nr. 5, datë 12.3.2022, si dhe nenit 21/5, të aktit normativ nr. 8, datë 25.3.2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 8450, datë 24.2.1999, ‘Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre’, të ndryshuar”,

VENDOSI:

1. Miratimin e çmimit tavan (max) të tregtimit me shumicë të produkteve, si më poshtë:
 - 236 lekë/litri për gazoilin;
 - 232 lekë/litri për benzinën;
 - 78 lekë/litri për gazin e lëngshëm të naftës.
2. Miratimin e çmimit tavan (max) të tregtimit me pakicë të produkteve, si më poshtë:
 - 248 lekë/litri për gazoilin;
 - 244 lekë/litri për benzinën;
 - 90 lekë/litri për gazin e lëngshëm të naftës.
3. Efektet e këtij vendimi fillojnë në datën 1.6.2022, ora 18:00, deri në një njoftim të dytë të marrë në mbledhjen e radhës.
4. Ky vendim është i detyrueshëm për të gjitha shoqëritë që tregtojnë me shumicë/pakicë produktet dhe nënproduktet e naftës dhe gazit, në zbatim të aktit normativ nr. 5, datë 12.3.2022 dhe nr. 8, datë 25.3.2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 8450, datë 24.2.1999, ‘Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre’, të ndryshuar”.
5. Ky vendim të publikohet në Fletoren Zyrtare, si dhe në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet.

Kryetare: Delina Ibrahimaj

Anëtarë: Belinda Balluku, Sezar Beqaj, Ceno Klosi, Genti Gazheli, Niko Lera, Ilia Gjermani, Enea Karakaçi, Artur Llogoni, Gerian Kuqi, Agron Bulku, Saimir Krasniqi